



Drejtuar: Operatorit ekonomik “Tower” shpk

Adresa: Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. Fadil Rada, Pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, Ap.9, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim”, “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i segmetit rrugor dhe pedonales nga sheshi “Frederik Shopen” deri në kryqëzimin me rrugën e “Kosovarëve”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i segmetit rrugor dhe pedonales nga sheshi “Frederik Shopen” deri në kryqëzimin me rrugën e “Kosovarëve”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-90863-03-24-2021

Fondi limit: është 1,888,707 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

Kohëzgjatja e kontratës: 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për këtë objekt.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 06.04.2021, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 54 datë 12.04.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” shpk, NUIS M01308013C

Vlera e ofertës = 1,673,449.73 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk, NUIS L01717030C

Vlera e ofertës **1,673,450** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Tower” shpk, NUIS L21717003H

Vlera e ofertës = **1,673,450** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” shpk, NUIS K71828007J

Vlera e ofertës = **1,680,344** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “ASH Engineering” shpk, NUIS L31617003F

Vlera e ofertës = **1,690,000** (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomikë përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” shpk NUIS M01308013C

- Operatori ekonomik "Engineering Consulting Group" shpk nuk plotëson pikën 2.4 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj”* pasi në listën e paraqitur nuk janë deklaruar punonjësi i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe punonjësi i pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.
- Operatori ekonomik "Engineering Consulting Group" shpk, për punonjësit inxhinier ndërtimi, inxhinier elektrik, inxhinier mjedisi dokumenti “diplomë” është paraqitur fotokopje i pashoqëruar me vërtetimin e njëhimit të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me përcaktimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”*.
- Operatori ekonomik "Engineering Consulting Group" shpk nuk plotëson përcaktimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* pasi faturat shoqëruese të kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit janë paraqitur fotokopje të pashoqëruar me vërtetimin e njëhimit të kopjes me origjinalin.

2. Operatori ekonomik “Novatech Studio” shpk, NUIS L01717030C

- Operatori ekonomik "Novatech Studio" shpk nuk plotëson gërmën “ç” të pikës 1 të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5” pasi deklarata nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik "Novatech Studio" shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 2.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në dy vitet e fundit ushtrimore 2019, 2020, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera fondit limit” pasi nuk është paraqitur vërtetim për xhiron për vitin 2020.
- Operatori ekonomik "Novatech Studio" shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 2.6 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “List pagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2020-Shkurt 2021 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” pasi nuk janë paraqitur formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“Tower” shpk**, me adresë: *Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. Fadil Rada, Pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, Ap.9, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1,673,450** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodri Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 08.04.2021.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim i segmentit rrugor dhe pedonale nga sheshi “Frederik Shopen” deri në kryqëzimin me rrugën e “Kosovarëve”, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 15230 Prot. datë 13.04.2021 (administruar në dosjen e prokurimit).

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin Nr.12229/3 Prot. dt. 13.04.2021 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 12229/4 Prot. datë 13.04.2021 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Ankimuesit konkludoi në mospranimin e ankesës, duke i kthyer përgjigje Operatorit ekonomik me shkresën me Nr. 15230/2 Prot., datë 21.04.2021 (administruar në dosjen e prokurimit).

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga pala ankimuese pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mbështetje të Nenit 63, pika 6 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), nuk u paraqit asnjë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.